



[Handwritten signature]

1. Pranimin e kërkesës.
2. Urdhërohet heqja e sekuestros konservative në kuotat e paditësit Bardhul Zuna pranë subjektit "Zuna" sh.p.k me NIPT K36309769F.
3. Urdhërohet pezullimi i të gjitha veprimëve për ekzekutimin e titullit ekzekutiv "Kontratë e huasë nr.11 Rep dhe 132 Kol., datë 26.09.2005" për sa i përket debitorit Bardhul Zuna deri në zgjidhjen përfundimtare të gëshjes civile nr.337 Akti, datë regj.05.08.2022.
4. Një kopje e këtij vendimi t'i bashkohet fashikullit të gëshjes civile nr.337 akti, datë regj.05.08.2022.
5. Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë bërë paraprakisht.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të arsyetuar.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës për sigurim padie, në gëshjen gjyqësore me paditës Bardhul Zuna, palë të paditur të shogëria "Micro Credit Albania", dhe persona të tretë pëmbarduesi gjyqësor privat Fatos Alimadhi dhe pëmbarduesi gjyqësor privat Helidon Xhindi me objekt: "Marrija e masës së sigurimit të padisë duke urdhëruar heqjen e sekuestros konservative në kuotat e paditësit pranë subjektit "ZUNA" Sh.p.k me NIPT K36309769F...", Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibrë me vendimin e saj nr.365, datë 07.12.2022 ka vendosur:

PËRPARA QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

BAZA LIGJORE: Nenet 208; 510/a, 511 të K.Pr.Civile


OBJEKTI : Vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendimit nr.365, datë 07.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibrë.

KËRKUES: Bardhul Zuna, i biri i Selimit dhe Kujtimës, i datëlindjes 19.07.1970, lindur në Sohodoll Dibrë dhe banues në lagjen "Aksioni", Njësia Administrative Peshkopi, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr.033992165 dhe nr. personal H00719004R, nr. cel 0682072911.

(Për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv)

KËRKESË

Peshkopi, më 09.07.2023



Nr. Prot: 14155

Ndonëse vendimi përkatës ju është njoftuar rregullisht palëve ndërgjyqëse, pas shkakimit të një kopjeje të ekstraktit të historik subjektit "Zuna" shpk nga platforma qeveritare e-albania, kam konstatuar se vendimi i gjykatës nuk është ekzekutuar.

Në kushte të tilla, dhe kur përmbanuesit gjyqësor privat Fatos Alimadhi i cili ka urdhëruar vendosjen e sekuestros në kuotat e mija pranë subjektit "Zuna" shpk, i është hequr licenca e përmbanuesit gjyqësor privat, referuar parashikimeve të nenit 208 në lidhje me nenin 510/1/a të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se vendimi nr.365, datë 07.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibrë për sigurimin e padisë sipas dispozitivit të këtij vendimi për tën titull ekzekutiv, ndaj po ju drejtohem me anë të kësaj kërkesë për të vënë në ekzekutim këtë titull ekzekutiv, për sa parashikon dhe neni 511 i K. Pr.Civile.

Sa më sipër, si dhe bazuar në nenet 510/1/a dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile i kërkojmë Qendrës Kombëtare të Biznesit të vejë në ekzekutim titullin ekzekutiv vendimin nr.365, datë 07.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibrë për martjen e masës së sigurimit të padisë heqjen e sekuestros konservative në kuotat e paditësit Bardhul Zuna pranë subjektit "Zuna" sh.p.k me NIPT K36309769F.

Bashkëngjitur kërkesës:

1. Vendim nr.365, datë 07.12.2022.

KËRKUES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

Nr. Regj. Them. (21238-00580-33-2022) 479

Data e regjistrimit: 05.12.2022

Nr. Vendimit: 365
Data e vendimit: 07.12.2022

VENDIM I NDËRMJETËM

(Për sigurimin e padisë)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër e përbërë nga:

GJYQTAR: ARDIT KUKA

Asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Aurora Sallahi në Peshkopi, sot më datë 07.12.2022 në seancë gjyqësore publike, pasi mori në shqyrtim gëshjen civile, që i përket:

PADITËS:

Bardhul Zuna, atësia Selim, amësia Kujtime, i datëlindjes 19.07.1970, lindur në fshatin Sohodoil, Bashkia Dibër dhe banues në lagjen "Aksioni", Njësia Administrative Peshkopi, Bashkia Dibër, me shtetësi shqiptare, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Z. Ervin Zuna (vëllai).

I PADITUR:

Shoqëria tregtare "Micro Credit Albania" sh.p.k., me NIPT L41729001H, me seli në Bashkinë Tiranë, Njësia Administrative Nr. 9, Rt. "Reshit Petrela", Hyrja 1, Ap. 1, në *mungesë*.

PERSON I TRETË:

1. Zyra e Përmbarimit "Alimadhi sh.p.k", me përmbarues privat Z. Fatos Alimadhi, me adresë: Bashkia Tiranë, Rt. "Muhamet Gjollëshha", Pall. 18, Shk 8, K 2, Ap. 52, në *mungesë*.
2. Përmbaruesi gjyqësor privat Z. Helidon Xhindi, me adresë: Bashkia Tiranë, Rt. "Thanas Ziko", Pall. 65/1, K. 1, në *mungesë*.

OBJEKTI:

1. Martjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar heqjen e sekuestros konservative në kuotat e paditësit Bardhul Zuna pranë subjektit "Zuna" sh.p.k me NIPT K36309769F.
2. Pezullimin e të gjitha veprimeve për ekzekutimin e titullit ekzekutiv "Kontratë e huasë nr. 11 Rep dhe nr 132 Kol., datë 26.09.2005" për sa i përket debitorit Bardhul Zuna deri në zgjidhjen përfundimtare të gëshjes civile nr. 337 Akti, datë regj. 05.08.2022.



BAZA LIGJORE:

Nenet 79, 92/a-b, 663 të Kodit Civil, Nenet 31, 36, 102, 153 dhe 154 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet e administruara në dosje,

VERËN:

Paditësi Z. Bardhul Zuna i është drejtuar Gjyqësor Dibër me padinë me objekt: "1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Kontratës së huasë nr. 11 rep dhe nr 132 kol., datë 26.09.2005, e lidhur ndërmjet huadhënësit Opportunity Albania sh.a. (sot NOA sh.a) dhe huamarrësit Metulla Xhelili, sa i takon dorëzimit të paditësit në këtë kontratë. 2. Zgjidhjen e pasojave të shkaktuara nga kjo kontratë ndaj palës paditëse, duke hequr sekuestron konservative të vendosur ndaj pasurive të paditësit dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. 3. Përjashtimin nga shitya në ankand të pasurisë nr. 14/250+1-1, e llojit apartament, me kod unik 310109207, e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 3101. 4. Pëzullimin e procedurës për shityen e sendit në ankand, deri në përfundimin e gjyqimit të kësaj gëshije".

Nga Aktet e administruara në këtë gjykim rezultoi se midis palëve huadhënësit Opportunity Albania sh.a dhe huamarrësit Metulla Xhelili është lidhur Kontrata e huasës e siguruar me barrë siguruese, hipotekë dhe dorëzimi, datë 26.09.2005, që ka për objekt dhënie hua të shumës prej 400,000 (katërqind mijë) lekëve për një afat 24 muor, me normë interesi vjetore 24%, sipërcaktohet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur kontratës. Në pjesën hyrëse të kontratës janë cilësuar dorëzues shtetasit Agron Xhelili dhe Bardhyl Zuna.

Duke qenë se debitori kryesor nuk ka shlyer kështu e kredisë sipas grafikut të përcaktuar, kreditori i është drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Me Vendimin nr. 365, datë 28.12.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për titullin ekzekutiv Kontratën e huasë nr. 11 rep dhe nr. 132 kol., datë 26.09.2005. Me pas kreditori ka vijuar me procedurën përbarimorë, duke iu drejtuar shërbimit përbarimor privat. Me Urdhrin nr. 025813 prot., datë 04.03.2022 përbaruesi gjyqësor Fatos Alimadhi ka urdhëruar vënien në sekuestro konservative të pasurive të paluajtshme të debitorit Bardhul Salim Zuna dhe konkretisht: i) pasuria e paluajtshme nr. 14/250+1-1, e llojit apartament, sip. 49.7 m2, ZK 2932 dhe ii) pasuria e paluajtshme nr. 31/33-ND, ndërtesë, me sip. 137.8 m2. Konstatohet se kreditori ka ndryshuar përbaruesi, pasi me Shkresën nr. 1704420 prot., datë 10.05.2022 përbaruesi gjyqësor privat Z. Helidon Xhindi ka njoftuar për fillimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm debitorin Bardhul Zuna për të njëjtën kredi, duke i bërë të ditur se pas sekuestros konservative do të vijohet me veprimin e pjesës takuese të bashkëpronarit ose procedurën e shityes së sendit në ankand në tërësi.

Paditësi ndër të tjera ka kërkuar pezullimin e procedurës për shityen e sendit në ankand për dorëzimin, deri në përfundimin e gjyqimit të kësaj gëshije. Edhe pse formalisht nuk është emërtuar kërkesë për sigurimin e padisë, nga përmbajtja e kërkesës kuptohet se bëhet fjalë për këtë institut të procedurës civile. Mbështetur në Vendimin Unifikues Civil të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2012 padia duhet të kuptohet nga leximi në tërësi i saj.



domethënë leximi i pjesës përshkruese-arsyetuese dhe jo duke u kufizuar në pjesën hyrëse të aktit procedural të kërkesëpadisë. Gjithashtu gjatë seancës, përfaqësuesi i paditësit sqaroi, se objekt i kërkesës është sigurimi i padisë.

Me vendimin e ndërmjetëm datë 09.09.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibrë ka vendosur: Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë. 2. Urdhërohet pezullimi i procedurës për shfijen e sendit në ankand të titullit ekzekutiv Kontratë e huasë nr. 11 Rep dhe nr 132 Kol, datë 26.09.2005, urdhëri i ekzekutimit i lëshuar me Vendimin nr. 365, datë 28.12.2009 për sa i përket debitorit Bardhul Zuna deri në përfundimin e gëshjes. 3. Kundër këtij lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të arsyetuar. 4. Një kopje e këtij vendimi t'u njoftohet palëve dhe personave të tretë pjesëmarrës në procesin civil". Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur dhe gëshja është në pritje për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Gjatë kësaj kohe, përmbaruesi gjyqësor privat ka vijuar me kryerjen e veprimeve të tjera përmbarimore. Nga Ekstrakti i QKB i nxjerrë nga sistemi elektronik e-albania dhe vulosur elektronikisht nga QKB konform ligjit, rezultoi se nga ana e përmbaruesit gjyqësor është vendosur sekuestro konservative në kuotat e ortakut, paditësit Bardhul Zuna pranë subjektit "Zuna" sh.p.k me NIPT K36309769F.

Duke pretenduar se ky veprim procedural pengon vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare "Zuna" sh.p.k., ku paditësi është ortak, është kërkuar prej tij heqja e masës së sekuestros deri në përfundimin e gjykimit.

Për shkak të karakterit të ngutshëm të masës së sigurimit të padisë, Gjykata vendosi të shqyrtojë këtë kërkesë brenda afatit 5 ditor, duke njoftuar palët ndërgjyqëse dhe personat e tretë me mjetin më të shpejtë të komunikimit, me anë të telefonit. I padituri Micro Credit Albania sh.p.k nuk u paraqiti, megjithatë kishite dijeni nëpërmjet përfaqësuesit në seancën përgatitore të gëshjes së themelit. Gjithashtu nuk u paraqitën personat e tretë. Zyra Përmbarimore Alimadhi sh.p.k dhe Zyra Përmbarimore Helidon Xhindi nuk janë përgjigjur në thirrjen telefonike. Për këto njoftime janë mbajtur dokumentet përkatëse të njoftimit nga nëpunësit e administratës gjyqësore. Duke marrë parasysh nevojat e ngutshme të shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë, që sipas nenit 205, paragraf. 2 i K.Pr.C. mund të kryhet edhe në dhomë këshillimi, gjykimi vijoi në munngesë të palëve të tjerë, pra vetëm me praninë e paditësit.

Sigurimi i padisë është një masë me karakter të përkohshëm, që jepet nga gjykatat, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Kjo masë e përkohshme nuk paragjykon zgjidhjen e gëshjes në themel. Në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se sigurimi i padisë lejohet kur: a) padia mbështetet në dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Garancia mund të kërkohej edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a".

Nga interpretimi i nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile, arrihet në përfundimin se dy janë kushtet që duhet të plotësohen, në mënyrë kumulative, me qëllim që kjo kërkesë të pranohet: a) Ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohej mbrojtje në procesin gjyqësor.

Këtu nuk është e nevojshme, që të jetë vërtetuar plotësisht ekzistenca e së drejtës që është edhe objekti i shqyrtimit gjyqësor dhe që ka lidhje me themelin e gëshjes, por vetëm mundësia e ekzistencës së të drejtës që kërkohet të rivendoset.

b) Ekziston rreziku (ka arsye të dyshohet) që nga ekzekutimi i vendimit, të cenohet e drejta e paditësit, e cila të bëhet i pamundur ose e vështirë për t'u rivendosur në pas. Kur flasim për ekzistencën e rrezikut apo "dyshimin e arsyeshem" duhet të kemi parasysh se standardi i të provuarit duhet të jetë i tillë, që të krijohet te gjykatata dyshimin se ekziston rreziku dhe jo bindjen e plotë për ekzistencën e tij.

Në jurisprudencën e saj Gjykata e Lartë ka theksuar se siguri i padisë nuk mund të ketë për objekt të drejtën që pretendohet në themel. Masa e sigurimit të padisë nuk mund të ekuivalen i objektit të kërkesëpadisë. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues Civil Nr. 10, datë 24.03.2004 kanë arritur në konkluzionin se: "Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkoheshme të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri. E themë ndryshe, masa e përkohshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmblusjen e kërkitit të pales paditëse të shprehur në objektin e padisë"

Në rastin konkret, këto dy kushte plotësohen në mënyrë kumulative. Ekziston një e drejtë e mundshme për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin gjyqësor dhe konkretisht mbrojtja e së drejtës së dorëzantit për detyrimet që rëndojnë mbi bazën e marrëdhënies kontraktore huasë, të cilën ai ka marrë përsipër ta përmblushte, në rast mospërmblushe të plotë ose të pjesshme nga debitori kryesor, normuar nga nenet 585-600 dhe 801 e vijues të Kodit Civil. Paditësi Bardhul Zuna figuron dorëzant në Kontratën e huasë nr. 11 rep dhe nr 132 kol., datë 26.09.2005 dhe bazuar në nenin 592 të Kodit Civil dorëzantësi ka të drejtë t'i kundërejtojë kreditorit të gjitha prapësimet që mund t'i kundërejtonte këtij debitori dhe të kërkojë kompensimin e asaj që kreditori i detyrohet debitorit edhe sikur ky të ketë hequr dorë nga këto ose të ketë pranuar detyrimin. Gjithashtu ekziston rreziku, që nga ekzekutimi i vendimit të cënohen të drejtat e paditësit. Bllokimi i asetëve të paditësit, sikurse janë kuotat e tij në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Zuna" sh.p.k., mund t'i sjellin një dëm të rëndë, pasi pamundësojnë administrimin e këtij subjekti tregtar. Sekuestro konservative mbi kuotat pengon shoqërinë që të realizojë veprimtarinë e saj tregtare, pasi mund të përbejë rrezik për formimin e kuorumit të nevojshëm për marrjen e vendimeve me rëndësi për ecurinë e aktivitetit të kësaj shoqërie.

Rezultoni se padia mbështetet në prova me shkresë. Paditësi ka paratqitur në cilësinë e provave shkresore Kontratën e huasë nr. 11 rep dhe nr 132 kol., datë 26.09.2005, Urdhrit nr. 1704420 prot., datë 05.09.2022 përmbanuesi gjyqësor Fatos Alimadhi ka udhëruar vënien e sekuestros mbi kuotat e debitorit Bardhul Selim Zuna, si dhe Ekstraktin e QKB-së, datë 25.11.2022, ku faktohet vënja e sekuestros mbi kuotat e shoqërisë në datën 01.11.2022. Përtaqësuesi i paditësit pretendoi se kontrata e huasë nuk është nënshkruar nga dorëzantësi Bardhul Zuna. Prima facie, nga vështirimi me sy të lirë i kontratës së huasë, që shërben edhe si kontratë dorëzanie, pasi janë në të njëjtin akt, janë shkruar me shkrim shtypi emrat e dorëzantëve

Bardhul Zuna dhe Agron Xhelili, por ndërsa poshtë emrit të shtetasit Agron Xhelili ka nënshkrim (firmë, shkrim dore), poshtë emrit të shtetasit Bardhul Zuna nuk ka nënshkrim (firmë, shkrim dore). Pra, ekzistojnë prova shkrese që krijojnë dyshimin për ekzistencën e së drejtës së paditësit. Gjithsesi Gjykata nënvizon se pranimi i kësaj kërkesë nuk paraqet zgjidhjen e çështjes në themel, që do të realizohet pas shqyrtimit të detajuar të provave dhe degjimit të pretendimeve të palëve në përputhje me parimin e kontradiktoritit.

Për sa i përket llojit të masave të sigurimit të padisë, neni 206 i K.Pr. Civile përcakton se sigurimi i padisë bëhet: a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit; b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata. Sigurimi i padisë mund të lejohet me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë. Sekuestro nuk mund të vihet mbi sende që, sipas nenet 529 të këtij Kodi, nuk mund të sekuestrohen. Në çështjen objekti gjykimimi vlerësohet se duhet të hiqet sekuestro konservative në kuotat e paditësit Bardhul Zuna pranë subjektit "Zuna" sh.p.k me NIPT K36309769F, si dhe të pezullohen të gjitha veprimet për ekzekutimin e titullit ekzekutiv "Kontratë e huasë nr. 11 Rep dhe nr 132 Kol., datë 26.09.2005" për sa i përket debitorit Bardhul Zuna deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes civile të regj. 05.08.2022, si rrethanë "masë tjetër e përshtatshme e marrë nga gjykata" e parashikuar nga neni 206, pika b) e K.Pr. Civile.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa për sigurimin e padisë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Diber, bazuar në nenet 125, 202, 206, 208, 308 të Kodit të Procedurës Civile,


VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Urdhërohet heqja e sekuestros konservative në kuotat e paditësit Bardhul Zuna pranë subjektit "Zuna" sh.p.k me NIPT K36309769F.
3. Urdhërohet pezullimi i të gjitha veprimeve për ekzekutimin e titullit ekzekutiv "Kontratë e huasë nr. 11 Rep dhe nr 132 Kol., datë 26.09.2005" për sa i përket debitorit Bardhul Zuna deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes civile nr. 337 Akti, datë regj. 05.08.2022.
4. Një kopje e këtij vendimi t'i bashkohet fashikullit të çështjes civile nr. 337 Akti, datë regj. 05.08.2022.
5. Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë bërë paraprakisht.
6. Kundër këtij lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të arsyetuar.

U shpall në Peshkopi, më datë 07.12.2022

SEKRETARE

AURORA SALLAHI



Secundum Verba

